

DEKRET
Nr.7398, datë 8.7.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës
Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Hekuran Isai emërohet zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Punëve të Brendshme.
 2. Simon Stefani lirohet nga funksionet e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave e të Ministrisë të Punëve të Brendshme, dhe emërohet kryetar i Komisionit të Planit të shtetit.
 3. Manush Myftiu lirohet nga funksionet e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të Kryetarit të Komisionit të Kontrollit të Shtetit, meqenëse del në pension.
 4. Prokop Murra lirohet nga funksioni i Ministrisë të Mbrojtjes Popullore, meqenëse del në pension.
 5. Kiço Mustaqi emërohet Ministër i Mbrojtjes Popullore.
 6. Vito Kapo lirohet nga funksioni i Ministres së Industrisë së Lehtë, meqenëse del në pension.
 7. Bashkim Sykaj emërohet Ministër i Industrisë së Lehtë.
 8. Jovan Bardhi lirohet nga funksioni i Ministrisë të Industrisë Ushqimore, meqenëse del në pension.
 9. Ylli Bufi emërohet Ministër i Industrisë Ushqimore.
 10. Xhemal Tafaj lirohet nga funksioni i Ministrisë të Ekonomisë Komunale, meqenëse kalon në një detyrë tjetër.
 11. Osman Murati lirohet nga funksioni i Ministrisë të Tregtisë së Brendshme, meqenëse kalon në një detyrë tjetër.
 12. Pajtim Ajazi emërohet Ministër i Tregtisë së Brendshme.
- Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA